



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2018:041958

Datë: 06.04.2022

Numri i dokumentit: 02888322

P.nr.519/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Rilind Sermaxhaj, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Eronita Llapashtica, në çështjen penale kundër të akuzuarit Sh I, nga Gjilani për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 9 lidhur me paragrafin 6 dhe paragrafin 1 të KPRK-ës dhe veprës penale mosdhënia e ndihmës personit të lënduar në fatkeqësinë e trafikut publik nga neni 382 paragrafi 1 i KPRK-ës, të cilin sipas autorizimit e mbron avokati Ymer Huruglica nga Gjilani, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilani-Departamenti i Përgjithshëm me numër PP.II.nr.1098/2018 të datës 10.09.2018 dhe aktakuzës së ndryshuar me numër PP.II.nr.1098/2018 të datës 06.12.2012, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor me datë 22.03.2022 në të cilin kanë prezantuar prokurori i shtetit Halim Borovci, i akuzuari Sh I dhe mbrojtësi i tij avokati Ymer Huruglica nga Gjilani, me datë 23.03.2022 mori dhe publikisht shpalli ndërsa me datë 06.04.2022 përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari Sh I nga babai M, dhe nëna L., e lindur B., i lindur më ... në Gjilani, ku edhe jeton rruga "A. T.", numër ..., i pa martuar, i pa punë, ka të kryer shkollën e mesme, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

I.

Sepse me datë 05.07.2018, rreth orës 21:10 minuta në rrugën publike në fshatin . Komuna e Gjilanit, ka rrezikuar trafikun publik duke vu në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë e tyre ashtu që duke drejtuar automjetin e udhëtarëve të markës me targa të regjistrimit . në drejtim të Gjilanit ka vepruar në kundërshtim me nenin 53 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullat e Trafikut Publik që ka të bëjë me mos

përshtatjen e shpejtësisë së lëvizjes kushteve atmosferike dhe kushteve të rrugës për ta ndalur automjetin para çdo pengese të paraqitur në rrugë si dhe kujdesi i shtuar i drejtuesit të automjetit ndaj pjesëmarrësve të tjerë në trafik-neni 149 i po të njëjtit ligj ashtu që me të arritur në afërsi të shtëpisë së B. H. në fshatin ., me pjesën e përparme të anës së djathtë të automjetit e godet mbrapa në rrotën e pasme biçikletën të cilën e drejtonte tani i ndjeri S. Z.nga fshati . Komuna e Gjilanit e që në momentin kritik ishte duke lëvizur përskaj rrugës në anën e djathtë në të njëjtin drejtim të lëvizjes, të njëjtin e përplas krejtësisht në anën e djathtë jashtë aksit rrugor duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore ndërsa së bashku me pasagjerët ik nga vendi i ngjarjes pa i dhënë ndihmën e nevojshme të dëmtuarit ndërsa të lënduarin disa qytetar e dërgojnë në Spitalin Regjional të Gjilanit dhe nga aty për shkak të gjendjes së rëndë i njëjti transferohet në QKUK në Prishtinë dhe nga koha e aksidentit të shkaktuar i ndjeri ishte në gjendje kome- pa vetëdije ndërsa me datë 13.11.2018 si pasojë e lëndimeve të pësuarat i njëjti vdes në Repartin Intensiv në QKUK në Prishtinë.

-Me çka ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 9 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të KPRK-ës.

II.

Sepse me datën, vendin dhe kohën e kryerjes së veprës penale ashtu si ajo e përshkruar në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, i akuzuari Sh I pas kryerjes së aksidentit të shkaktuar nuk i ofron ndihmën e nevojshme personit të cilin rëndë e kishte lënduar por ashtu me shpejtësinë që ishte duke e zhvilluar ikë nga vendi i ngjarjes duke e lënë të ndjerin në gjendje të rëndë dhe pa vetëdije jashtë aksit rrugor, fillimisht e parkon automjetin në lagjen “.” ndërsa më pas largohet nga Kosova dhe ikë e del në Shqipëri dhe Turqi duke u ndihmuar nga i akuzuari Ç. T. K. dhe në këtë mënyrë i akuzuari me mosveprim e ka lënë të dëmtuarin në gjendje të rëndë shëndetësore duke mos i dhënë ndihmën e nevojshme shëndetësore.

-Me çka ka kryer veprën penale mosdhënia e ndihmës personit të lënduar në fatkeqësinë e trafikut rrugor nga neni 382 paragrafi 1 i KPRK-ës.

Andaj, në bazë të neneve 4, 41, 42, 43, 45, 73, 74, 75 dhe 76 të KPRK-ës dhe neneve 326 dhe 365 të KPP-ës të akuzuarin Sh I:

E GJYKON

Për veprën penale nga pika I e dispozitivit të këtij aktgjykimi me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 8 (tetë) muajve ndërsa

Për veprën penale nga pika II e dispozitivit të këtij aktgjykimi me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve.

Në bazë të nenit 80 paragrafi 1 dhe 2 nën paragrafi 2.2 të KPRK-ës, të akuzuarit i shqiptohet DËNIM UNIK ME BURGIM NË KOHËZGJATJE PREJ 2 (dy) viteve i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Në bazë të nenit 83 të KPRK-ës të akuzuarit të lartcekur koha e kaluar nën masën e paraburgimit nga data 30.07.2018 deri me datë 28.08.2018 do ti llogaritet në dënimin unik të shqiptuar me burgim.

Në bazë të nenit 62 paragrafi 1, nën paragrafi 2.5 të KPRK-ës ndaj të akuzuarit të lartcekur shqiptohet edhe DËNIMI PLOTËSUES- NDALIMI I DREJTIMIT TË AUTOMJETIT në kohëzgjatje prej 1 (një) viti duke u llogaritur nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë derisa koha e kaluar në burg nuk llogaritet në kohëzgjatjen e këtij dënimi.

Në bazë të nenit 182 paragrafi 4 të KPP-ës ndaj të akuzuarit Sh I HIQET MASA E DORËZANISË e caktuar sipas aktvendimit të kësaj gjykate PPr.nr.142/2018 ashtu që shuma prej 4000 € (katërmijë euro) e deponuar si dorëzani I KTHEHET të njëjtit në momentin kur të ketë filluar mbajtjen e dënimin.

Përfaqësuesit e të dëmtuarit-ndjerit S. Z. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko-civil.

Obligohet i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë shumën prej 450 € (katërqindpesëdhjetë euro) për hartimin e super ekspertizës së komunikacionit dhe shumën prej 132.86 € (njëqindetridhjetedy euro e tetëdhjetegjashtë cent) për hartimin e ekspertizës së komunikacionit gjithashtu obligohet i akuzuari që ta paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 100 € (njëqind euro) si dhe shumën prej 30 € (tridhjetë euro) për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

ARSYETIM

1.Rrjedha e çështjes dhe fjalët përfundimtare të palëve.

Prokuroria Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm me datë 17.09.2018 ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr.1098/2018 kundër të akuzuarit Sh I për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 i KPRK-se dhe veprës penale mosdhënia e ndihmës personit të lënduar ne fatkeqësinë e trafikut publik nga neni 382 paragrafi 1 i KPRK-ës¹ dhe të akuzuarit Çagdash Kaya² për shkak të veprës penale dhënia e ndihmë kryerësve pas kryerjes së veprave penale nga neni 388 paragrafi 1 të KPRK-së ndërsa e njëjta prokurori me datë 06.12.2018 ka paraqitur aktakuzën e ndryshuar në raport me të akuzuarin Sh I edhe atë vetëm sa i përket kualifikimit juridik të veprës penale meqenëse i ndjeri S. Z. 13.11.2018 kishte ndërruar jetë si pasojë e lëndimeve të marra në aksidentin e komunikacionit të shaktuar nga i akuzuari Sh I dhe i njëjti ishte akuzuar për veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 9 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të KPRK-se.

Me datë 22.03.2022 pranë kësaj gjykate është mbajtur seanca e shqyrtimit gjyqësor në të cilin kanë prezantuar prokurori i shtetit H. B. dhe i akuzuari Sh I me mbrojtësin e tij avokatin Ymer Huruglica, me ç'rast pas leximit të provave materiale dhe me rastin e dhënies së mbrojtjes nga ana e të akuzuarit i akuzuari ka deklaruar se pas administrimit të provave materiale përshirë edhe super ekspertizën e komunikacionit si dhe pas konsultimit me mbrojtësin e tij dëshiron të deklarohet lidhur me fajësinë dhe se e pranon fajësinë për veprën penale me të cilën akuzohet nga pika I e dispozitivit të aktit akuzues (për pikën II të dispozitivit të aktit akuzues i njëjti në seancën e shqyrtimit fillestar e kishte pranuar fajësinë), pranim i fajësisë ky i cili nuk ishte kundërshtuar nga ana e palëve prezente andaj gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 326 të KPP-ës ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë nga ana e të akuzuarit Sh I dhe më pas seanca e shqyrtimit gjyqësor ka vazhduar me fjalët përfundimtare të palëve

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se meqenëse në këtë faze të procedurës i akuzuari Sh I e pranoi fajësinë në mënyre të lirë dhe vullnetare pas konsultimit me mbrojtësin e tij dhe njoftimit lidhur me benefitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë ashtu siç përshkruhet në këtë aktakuzë e cila është e mbështetur edhe në provat e tjera materiale, në dy ekspertiza, në deklaratimet e dëshmitarëve andaj edhe mbetet pranë aktit akuzues dhe propozimeve të saja si dhe ka kërkuar që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit dhe me rastin e caktimit të llojit dhe

¹ I akuzuari Sh I për veprën penale mosdhënia e ndihmës personit të lënduar ne fatkeqësinë e trafikut publik nga neni 382 paragrafi 1 i KPRK-ës e ka pranuar fajësinë në seancën e shqyrtimit fillestar të datës 18.03.2021.

² Për të akuzuarin Çagdash Kaya në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 07.07.2021 ishte veçuar procedura penale meqenëse i njëjti e kishte pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihej në barrë dhe më pas i njëjti ishte dënuar me dënimin përkatës sipas aktgjykimit të kësaj gjykate me numër P.nr.821/2018 të datës 15.07.2021

lartësisë së dënimit të merren parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese e që dënimi të jetë proporcional me dëmin e shkaktuar dhe rrezikshmërinë shoqërore më anë të kësaj vepre penale.

Mbrojtësi i të akuzuarit Sh I, avokati Ymer Huruglica në fjalën përfundimtare ka deklaruar se meqenëse i mbrojturi i tij e ka pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohet dhe ky pranim që e kishte bërë edhe në seancat e mëhershme përveç arsyes që e kishin paraqitur në kërkesën për hedhjen e aktakuzës dhe se me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit ka kërkuar nga gjykata që pas vlerësimit të të gjitha rrethanave lehtësuese dhe rënduese të akuzuarit ti shqiptojë një dënim sa më të butë, me tutje mbrojtësi i të akuzuarit ka deklaruar se nga këto arsye në anën e të akuzuarit ka mjaft rrethana lehtësuese që do të vërtetonin propozimin e paraqitur me lartë dhe atë gjykata duhet të vlerësojë si rrethanë lehtësuese rrethanat personale dhe karakterin e të akuzuarit e sidomos në këtë raport që i njëjti me parë nuk ka qenë i gjykuar, ka pasur sjellje korrekte gjatë gjykimeve, vazhdimisht ka shprehur keqardhje për atë që i ka ndodhur, po ashtu që gjykata duhet të ketë parasysh edhe rrethana tjera si mosha e re e të akuzuarit, bashkëpunimi i përgjithshëm i tij si me gjykatë ashtu edhe me palën e dëmtuar, sjellja e tij para dhe pas aksidentit si dhe gjykata të ketë parasysh që tani i ndjeri ka pësuar lëndim të rëndë trupor në ditën e aksidentit me datën 05.07.2018 ndërsa ka ndërruar jetë me datë 13.11.2018 e që gjatë kësaj kohe familja e të mbrojturit të tij për çdo ditë i është gjetur afër tani të ndjerit materialisht po ashtu i mbrojturi i tij ka qenë i prerë që të dëmtuarin ta dërgojë jashtë shtetit për shërim mirëpo kjo nuk ka qenë e mundur për shkak të mospëlqimit të mjekëve meqenëse kjo nuk do të ishte e sigurtë, po ashtu i akuzuari dhe familja e tij sipas traditave të vendit janë lejuar që të shprehin ngushëllime dhe të marrin pjesë në varrim dhe se të njëjtat familje i kanë të relaksuara raportet si dhe duke mbështetur në rrethanat e cekura me lart gjykata duhet të vlerësojë si rrethanë posaçërisht lehtësuese pranimin e fajësisë dhe ti shqiptojë një dënim sa më të butë gjithnjë duke konsideruar se ka vend për zbutjen e dënimit sipas nenit 75 të KPRK-se dhe me këtë mund të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 41 të KPRK-se përkatësisht dispozitave në fuqi të kodit penale të mëparshëm, po ashtu ka shtuar se i mbrojturi i tij para dhe pas aksidentit nuk është person i njohur me sjellje apo vozitje devijante në trafik por siç është cekur edhe në aktakuzë deri tek fatkeqësia ka ardhur si pasojë e pakujdesisë së pamjaftueshme në komunikacion.

I akuzuar Sh I në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështetë në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij, i vie keq për rastin e ndodhur, i ka kërkuar falje familjes së të ndjerit dhe ka kërkuar nga gjykata një dënim sa më të vogël.

2.Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjykata me rastin e pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë si në kuptim të nenin 326 lidhur me nenin 248 të KPP-së dhe se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit nuk është kundërshtuar nga ana e palëve prezente. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i akuzuari e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarit pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, se i akuzuari nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza siç janë: raporti i policit, deklarata e dëshmitarit Sh. Z., deklarata e dëshmitarit R. V., deklaratat e të akuzuarit Sh I, CD me video incizim, foto dhe skica nga vendi i ngjarjes, raportet e shpejta të përpiluara nga oficerët policor, raporti mjekësor me numër ... në emër të ndjerit S. Z., ekspertiza e komunikacionit e datës 22.08.2018, super ekspertiza e komunikacionit e datës 16.03.2022 si dhe shkresat e tjera të lëndës gjithashtu gjykata me rastin e pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit gjeti se aktakuza lëndore nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartë cekurat gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: i akuzuari Sh I nga Gjilani ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 9 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të KPRK-se dhe veprën penale mosdhënia e ndihmës personit të lënduar në fatkeqësinë e trafikut publik nga neni 382 paragrafi 1 i KPRK-ës në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në pikat I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

4. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të akuzuarit duhet ti shqiptohet dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, sjelljen dhe rrethanat e kryesit si dhe përgjegjësinë penale të tij, gjykata me rastin e matjes së dënimit pati parasysh rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit si në kuptim të nenit 73 të KPRK-ës ashtu që gjykata mori parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të kryesit e cila në vetvete përfshin shkallën e përgjegjësisë dhe fajësisë meqenëse i akuzuari në kohën e kryerjes së veprave penale ka qenë plotësisht i përgjegjshëm për veprimet e veta, pastaj intensitetit e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale si dhe pranimin e fajit nga ana e të akuzuarit. Me rastin e matjes së dënimit gjykata pati parasysh edhe rregullat e përgjithshme të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit si në kuptim të nenit 74 të KPRK-ës ashtu që si rrethana lehtësuese për të akuzuarin mori

pranimin e fajësisë për veprat penale të cilat i vihet në barrë, keqardhjen e shfaqur nga i akuzuari në çdo stad të procedurës penale për veprat penale të kryera, pendimin e tij për kryerjen e këtyre veprave penale, kërkim faljen në raport me familjen e të ndjerit, premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të nuk do të kryej vepra të tilla dhe as vepra të tjera penale ndërsa si rrethana rënduese për të akuzuarin gjykata mori shkallën e dëmit të shkaktuar me veprat penale e cila përfshinë vdekjen e të ndjerit S. Z. i cili ka ndërruar jetë me datë 13.11.2018 si pasojë e lëndimeve të marra nga aksidenti i shkaktuar prej të akuzuarit, pastaj shkallën e lartë të dashjes në raport me veprën penale nga pika II e dispozitivit të këtij aktgjykimi ngase i akuzuari pas shkaktimit të aksidentit përkundër që të ndjerin e kishte hedhur jashtë rrugës nuk e ndalon automjetin për ti dhënë ndihmën e nevojshme por vazhdon rrugën dhe më pas largohet nga Kosova për në Shqipëri e më pas në Turqi andaj duke u bazuar në të lartcekurat dhe në kuptim të nenit 75 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPRK-ës të akuzuarit i shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi gjithnjë duke konsideruar se me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit mund të arrihen qëllimet e dënimit si në kuptim të nenit 41 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

5.Llogaritja e paraburgimit në dënimin e shqiptuar

Gjykata duke u bazuar në nenin 83 të KPRK-ës të akuzuarit Sh I kohën e kaluar nën masën e paraburgimit nga data 30.07.2018 deri me datë 29.08.2018 ia llogariti në dënimin unik me burgim të shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

6.Vendimi për shqiptimin e dënimit plotësues.

Gjykata pas analizimit dhe vlerësimit të propozimit të prokurorit të shtetit që ndaj të akuzuarit të shqiptohet edhe dënimi plotësues Ndalimi i Drejtimit të Automjetit nga neni 62 paragrafi 1 dhe 2 nën paragrafi 2.5 dhe neni 67 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-ës gjeti se një propozim i tillë është i bazuar dhe të akuzuarit ia shqiptoj dënimin plotësues ndalimi i drejtimit të automjetit për faktin se në këtë çështje penalo juridike është vërtetuar se i akuzuari me kryerjen e veprës penale ka rrezikuar sigurinë në trafikun publik duke shkaktuar aksident trafikut dhe si pasojë e këtij aksidenti ka ndërruar jetë i ndjeri Selver Zeneli.

7.Vendimi lidhur me dorëzanimë.

Me aktvendimin e kësaj gjykate me numër PPr.nr.142/2018 të datës 28.08.2018 të akuzuarit të lartcekur masa e paraburgimit i ishte zëvendësuar me masën e dorëzanimë për të cilën i njejt kishte deponuar shumën prej 4000 € (katërmijë euro) andaj duke pasur parasysh se i akuzuari ka pranuar fajësinë për veprën penale dhe të njëjtit i është shqiptuar dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi , gjykata në kuptim të nenit 182 paragrafi 4 dhe 5 të KPP-ës ka vendosur që ndaj tij të hiqet masa e dorëzanimë dhe që shuma prej 4000 € (katërmijë euro) e deponuar si dorëzani në bazë të aktvendimit të lartcekur të i kthehet të njëjtit në momentin kur të ketë filluar mbajtjen e dënimit.

8. Vendimi lidhur me kërkesën pasurore juridike

Lidhur me kërkesën pasurore juridike gjykata në bazë të nenit 463 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-ës për realizimin e saj përfaqësuesit e të ndjerin S. Z. i ka udhëzuar në kontest të rregullt juridiko-civil.

9.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të akuzuarit, gjykata duke u bazuar në nenin 450 dhe 451 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që të akuzuarin ta detyrojë të paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë shumën prej 450 € (katërqindpesëdhjetë euro) për hartimin e super ekspertizës së komunikacionit dhe shumën prej 132.86 € (njëqindetridhjetedy euro e tetëdhjetegjashtë cent) për hartimin e ekspertizës së komunikacionit gjithashtu obligohet i akuzuari që ta paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 100 € (njëqind euro) si dhe shumën prej 30 € (tridhjetë euro) për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.519/2021, me datë 06.04.2022

Zyrtarja Ligjore,
Eronita Llapashtica

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Rilind Sermahaj

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet Gjykatës Themelore në Gjilan.